



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Janar - dhjetor 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, Drejtoria e Shëndetësisë ka pranuar lëndë për t'u shqyrtuar nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori, ka pasur takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Monitorimi i aktiviteteve bazuar në specifikat e kontratave publike kornizë dhe furnizime;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planprokurimit 2019;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë;
- Shqyrtimi i mjeteve të ankimit me rrugë administrative;

- Mbarëvajtje e konkursit publike mbi personelin shëndetësor;
- Përgatitjet administrative rreth aktiviteteve në vitin fiskal 2020.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

- Zhvillimi dhe monitorimi i kontratës:
 - “Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objekteve shëndetësore”;
 - Renovim i hapësirave: radiologjike dhe laboratorike në QMF 5; kati përdhes;
 - Largim i materialit jo funksional në QMF 5, në mbikëqyrje nga komisioni i caktuar nga QKMF dhe DSH;
 - Renovim – laura QKMF;
 - Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objekteve shëndetësore në hapësira të ndryshme, bazuar në gjendjen aktuale të tyre: QKMF, rirenovim tavani QMF 6, QMF 8;
 - Renovime në hapësira të ndryshme, bazuar në gjendjen aktuale të tyre;
 - Takime dhe njoftime të vazhdueshme të ekipit menaxhues;
 - Vendosja e pllakave të qeramikës në QMF 9;
 - Identifikimi i defekteve në QMF 3 nga kontrata e skaduar, gjatë periudhës garantuese;
 - Renovimi i dyshemes në QKMF/ndërresa e natës;
 - Përmirësimi i hapësirës së pikës QMU, pika e re;
 - “Furnizim me material shpenzues stomatologjik”;
 - “Furnizim me material administrativ shëndetësor”;
 - “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor”;
 - “Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe RO Kabineti”;
 - “Furnizim me autoambulanca për nevoja të QMU-së”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore – ritenderim nga viti 2018”;
 - “Furnizim me material administrativ shëndetësor”;
 - “Pastrimi i objekteve shëndetësore”;
 - “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit të dy (2) fazat: pranverore dhe vjeshtore 2019”;
 - “Dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shëndetësore të dy (2) fazat: pranverore dhe vjeshtore 2019”;

- “DDD i objekteve shëndetësore dhe Bashkësisë Lokale – Bardhosh të filluar me 8 prill 2019”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore”;
 - “Furnizim me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore”;
 - “Vazhdim i kontratës së negociuar – Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore”;
 - “Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore”;
 - “Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës: fazat sipas kontratës, si dhe fazat shtesë”;
 - “Pastrimi i objekteve shëndetësore”;
-
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
 - Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
 - Bashkëpunim me ekipet menaxhuese;
 - Plan menaxhimi i kontratave – Proces prokurimi;
 - QKMF, ndarja e mirënjohjeve personelit të pensionuar gjatë vitit 2018;
 - QMU, ndarja e mirënjohjeve personelit për punën gjatë vitit 2018;
 - Identifikimi i nevojave rreth specifikave për procedure të tenderimit:
 - “Servisimi dhe mirëmbajtja e aparaturës mjekësore në QKMF dhe njësitë saj dhe QMU”;
 - “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU”;
 - “Furnizim me autoambulanca për nevoja të QMU”;
 - “Furnizimi me inventar për nevojat e QKMF dhe QMU”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore – pjesa II”;
 - “Digjitalizimi i objekteve shëndetësore”;
 - “Furnizim me material shpenzues laboratorik dhe RO kabineti”;
 - “Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së QMU”;
 - Procedurë negociuese – “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH-së”;
 - Përcaktimi i ekipit vlerësues:
 - “Furnizim me autoambulanca”;
 - “Furnizim me barna dhe material shpenzues”;
 - “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore”;
 - “Dixhitalizimi i objekteve shëndetësore”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore – ritenderim 2018”;

- "Furnizimi me material shpenzues Ro - Kabinete";
- "Furnizimi me inventar për nevojat e institucioneve shëndetësore";
- "Renovimi dhe permiresimi i infrastruktures se objektit QMU";
- "Furnizim me pajisje - pjesa II";
- "Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU";
- "Përcaktim ekipit menaxhues";
- "Furnizim me autoambulanca";
- "Dixhitalizimi i objekteve shëndetësore;
- "Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU";
- "Furnizim me inventar për nevojat e Institucioneve shëndetësore";
- "Furnizim me pajisje mjekësore";
- "Furnizim me barna dhe material shpenzues";
- "Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore";
- "Furnizimi me material shpenzues Ro - Kabinete";
- "Furnizim me pajisje mjekësore - ritenderim 2018";
- Sqarime shtesë në proces prokurimi:
 - "Furnizimi me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF dhe QMU dhe
 - "Furnizim me material shpenzues për nevojat laboratorike dhe RO";
- Përpilimi i raporteve: Raport vjetor 2018, si dhe Plan veprimi I DSH në vitin 2019;
- DSH zgjidhet anëtare e kryesisë së Trupave regjional për dialog social në regjionin e Prishtinës - Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës;
- Takim me Zyrën japoneze - mundësitë e aplikimit për grant;
- Përgatitja finale - konkursi ideor "Ndërtimi i QMF - Zona Perendim - Prishtina e Re;
- Përfundim i procesit vlerësues - Konkurs projektimi për Hartim të projektit ideor arkitektonik - Qendra e mjekësisë familjare në lagjen "Prishtina e Re - Zona e Perëndimit";
- Përgatitjet teknike rreth realizimit të aktiviteteve:
 - "Vizitat sistematike në shkollat fillore dhe SHMU në komunën e Prishtinës;
 - "Dezinsektimi hapësinor në komunën e Prishtinës";
 - "Deratizimi I garazheve dhe podrumeve publike";
 - "Deratizimi I rrjetit të kanalizimit" dhe
 - "Dezinfektimi dhe deratizimi I objekteve shëndetësore";
- Fillimi i vizitave sistematike të nxënësve të klasave I, V dhe IX, më 04.03.2019, për të përfunduar më 27.05.2019;
- Aktiviteti vazhdoi në përpilim dhe analizë të të dhënave;
- Publikimi dhe monitorimi i procesit - Testimi, intervistimi dhe përpilimi i listës përfundimtare të kandidatëve në konkursin publik;

- Përgatitja e raporteve buxhetore: javore dhe mujore, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- Mbikëqyrja, shfrytëzimi-realizimi i buxhetit përmes programit “Free balance”;
- Koordinimi i punëve dhe bashkëpunimi me QKMF-në dhe QMU -në Drejtorinë e Financave dhe Zyrën e prokurimit, për harxhimin e buxhetit në bazë të rrjedhës së parasë;
- Kontrollimi, mbikëqyrja e buxhetit dhe miratimi i tyre sipas fondit, kodit dhe kategorive ekonomike;
- Planifikimi, raportimi dhe mbajtja e evidencës së shpenzimeve të buxhetit (Mallrat dhe shërbime, komunale dhe subvencioneve);
- Alokimet;
- Pranimi i faturave;
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme;
- zotimet;
- Procedura të mëtutjeshme – Prokurim dhe Drejtori të Financave;
- Raportimi i shpenzimeve të realizuara në drejtori sipas kërkesave për raportim;
- Raportimi i obligimeve/borxheve më të vjetra se 30 ditë – Drejtori të Financave;
- Përgatitja e deklaratave të disponueshmëris për inicim të procedurave të prokurimit;
- Përgatitja e raportit final, të kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë rreth fondit të huamarrjes mbi përmisimin e qasjes në shërbime cilësore të kujdesit parësor shëndetësor (KPSH) në kuadër të Planit të veprimit për përmirësimin e performancës 2018;
- Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët, organizuar nga Zyra e Bashkimit Evropian/EUSR dhe Europe House me temën “Integrimi Gjinnor në Sektorin e Shëndetësisë”;
- Pjesëmarrës i personelit shëndetësor në hapjen e ekspozitës “Dhuna nuk fshihet brenda mureve” - Teatri Kombëtar, në sheshin “Skënderbeu”;
- Në kuadër të kolegjiut profesional në QKMF, takim me Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe me përfaqësues të SISH nga MSH, lidhur me sistemin e ri të SISH-së, që pritet të rifillojë edhe në Komunën e Prishtinës;
- Përgatitje teknike rreth rifunksionalizimit të SISH-së;
- Funksionalizohet shërbimi stomatologjik në Qendrën e Mjekësisë Familjare 3;
- Përcaktim i kushteve teknike rreth renovimeve në QMF 2 – Barnatore, hemodializa nga QKUK;

- Takime me AQH mbi përpilimin e planit të veprimit të DSH-së, Komuna e Prishtinës;
- Përpunim i të dhënave – Plani i Veprimit për përmirësimin e performancës;
- Takim me RRGK, me qëllim të promovimit të punës së institucioneve vendore në luftim të dhunës me bazë gjinore, me fokus në dhunën në familje;
- Takim me Organizatën për shëndetin mendor – Kuvendi Komunal;
- Pjesëmarrës në tryezë të rrumbullakët, organizuar nga UNFPA, Zyra në Kosovë, në shënimin e Ditës Botërore të Popullsisë;
- Përditësim i të dhënave – Prishtinaonline;
- Përgatitje administrative për konkursin publik mbi pozitat e lira në DSH;
- Analiza e rasteve të qytetarëve të atakuar të prekur nganga rriqrat – gjatë muajit qershor 2019 ndihmë kanë kërkuar 165 qytetarë;
- Kampanjë nga profesionistët shëndetësorë mbi rëndësinë e përcaktimit të grupit të gjakut;
- Njoftim mbi rezultatet e para të programit nacional për infarkt akut të miokardit me ST elevim brenda 120 minutave. Nga data 08.07.19 – 01.08.19, u shpëtuan 3 jetë;
- Pjesëmarrës në të gjitha dëgjimet publike me qytetarë;
- Bashkëpunim DMS dhe DSH, ekipet mjekësore QMU të gatshme për ofrim të shërbimeve shëndetësore në QPS;
- Takim pune me kolegë DIMK dhe OE rreth projektit “Ndërtimi i QMF Prishtina e Re – Zona përfundim”;
- Takim pune me kolegë nga Drejtoria e Urbanizmit, rreth zgjerimit të garazheve të QMU-së;
- Takim me MAP dhe profesionistë të tjerë rreth – Planit të fizibilitetit i ndërtimit të Spitalit të Prishtinës;
- Identifikimi i nevojave dhe përpilimi i buxhetit 2020;
- Përgatitjet teknike mbi përpilimin e Planit të prokurimit 2020;
- Përgatitjet teknike “Plani i Veprimit 2020”;
- Përgatitjet teknike rreth përcaktimit të aktiviteteve mbi zbatimin e planit të veprimit DSH, janar 2020 – procedure prokurimi;
- Plotësime të Planit të menaxhimit të kontratave të ndryshme;
- Pjesëmarrje në trajnim rreth proceduarve bazike të aktivitetit të prokurimit;
- Rishikim i planprogramit të aktiviteteve për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- Përgatitje teknike mbi procedurat e asgjësimit të barnave dhe materialit shpenzues medicinal;

- Përgatitje të dhënash mbi adresat e pacientëve me hemodializë, të cilët transportohen me veturë zyrtare – QKMF;
- Përpilim i specifikave të aktiviteteve bazuar në Planin e veprimit të vitit 2020:
 - DDD e objekteve shëndetësore;
 - Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore;
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore;
 - Furnizim me material shpenzues mjekësor dhe laboratorike;
- Pjesëmarrje në trajnim në fushat e Sistemit të menaxhimit të performancës komunale, mbështetur nga projekti SDC/Demos dhe Sida;
- Ndarja e mirënjohjeve për personelin shëndetësor, të cilët u pensionuan gjatë vitit 2019;
- Rifunksionalizimi i shërbimeve shëndetësore laboratorike dhe ndërresa e natës në QMF 5;
- Përmirësimi i infrastrukturës së parkingjeve në QMU, QMF 5 dhe QMF 6.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Organizimi dhe mbajtja e komisioneve për ndarje të subvencioneve – qytetarëve për ndihmë gjatë trajtimit mjekësor;
- Monitorimi i kontratave:
 - “Furnizim me material administrativ shëndetësor”;
 - “Renovime dhe rindërtime”;
 - “Furnizim me material shpenzues, stomatologjik”;
 - “Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve shëndetësore të Kujdesit Primar Shëndetësor”;
 - “Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës”;
 - “Deratizimi i rrjetit të kanalizimit dhe garazheve publike”;
 - “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore”;
 - “Furnizim me pajisje mjekësore, pjesa 2”;
 - “Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës së objektit QMU”;
 - “Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve mjekësore”;

- “Dixhitalizimi i objekteve shëndetësore”;
- Zbatimi i aktiviteteve bazuar në Planin e veprimit 2020.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

REALIZIMI I BUXHETIT Janar - dhjetor 2019		REALIZIMI		REALIZIMI		REALIZIMI
	10	%	21	%	22	%
BUXHETI SEKTORIAL - SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA						
PAGA dhe MËDITJE	5,868,367					
Të alokuara	5,868,367					
Të shpenzuara	5,868,367					
MALLRA dhe SHËRBIME				-		-
Të alokuara	582,647.00	99..49%	300,000.00	98..21%		
Të shpenzuara	579,683.69		294,636.81			
Mbetje	2,963.31		5,363.19			
Nr. lëndëve	432		152			
SHPENZIME KOMUNALE						
alokuara	310,000.00	81..70%				
shpenzuara	253,277.65					

Të lira	56,722.35					
Nr. lëndëve	726					
SHPENZIME KAPITALE						
Të alokuara	50,000.00	100..%	1,480,000.00	70..64%	636,899.74	37..20%
Të shpenzuara	50,000.00		1,045,444.82		236,956.42	
Të lira			434,555.18		399,943.00	
Nr. i lëndëve	1		34		5.00	

5.1.2 Takimet me palë

- DSH bën pranimin e palëve çdo ditë pune. Rreth 9 – 10 palë janë pranuar, me përjashtim të palëve të pranuar nga drejtori, ndërkaq drejtori kishte 3-5 takime në zyrë të DSH në baza javore.

5.1.3 Takimet me institucione të tjera

- Drejtoria e Shërbimeve Publike:
 - Lehtësimi i qarkullimit të veturave zyrtare me pacientë në mot me borë;
 - Lehtësimi i qarkullimit të autoambulancës në afërsi të objektit QMU;
 - Sigurimi i hapësirës për vendosje të materialit jofunksional nga QMF 5;
 - Kërkesë për vendosje të shtyllave antiparking – QMF 3;
 - Kërkesë për furnizim dhe mbjellje të drurëve dekorativë në objektet shëndetësore;
 - Vendime mbi mbajtjen e aktiviteteve në sheshe;
- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
 - Menaxhim i kontratës “Renovime dhe rindërtime”;
 - Përpilimi i specifikave “Ndërtimi i QMF Prishtina e Re – Zona Peendim”;
- Drejtoria e Prokurimit:
 - Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Administratës
 - Shtypja e Fletëpalosjeve për nder të Ditës së Shëndetit Oral
- Drejtoria e Parqeve:
 - Furnizim me lule në objektet shëndetësore;
- Drejtoria e Mirëqenies Sociale:
 - Informata në lidhje me ndarjen e subvencioneve;
- Drejtoria e Pronës:

- Kushtet ndërtimore – renovimi QMU
- Drejtoria e Arsimit:
 - Furnizim me lëndë ngrohëse – QMF Besi dhe AMF
 - Përpilimi i specifikave për kutinë e ndihmës së parë;
- Drejtoria e Pronës:
 - Kushtet ndërtimore – renovimi QMU;
- Drejtoria e Urbanizmit:
 - Zgjerimi i garazheve – QMU;
- Arkivi Komunal:
 - Informatë mbi objektin QMU.

5.1.4 Diskutime publike/takimet me qytetarë

Gjatë kësaj periudhe kishte rreth 9 – 11 qytetarë gjatë orarit të punës, çdo dite pune, përveç takimit të palëve me drejtorin.

5.1.5 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Drejtoria e Pronës:
 - Kushtet ndërtimore – renovimi QMU;
- Arkivi Komunal:
 - Objekti QMU;
 - Informata mbi objektet QKMF dhe njësitë e saj.

5.1.6 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

5.1.7 Përfitues të subvencioneve:

5.1.8 Takime të tjera

- Ministrinë e Shëndetësisë;
- Tv Klan;
- KTV;
- Federata e Sindikatave të Shëndetësisë;
- AQH;
- Fondacioni Together Kosova;
- RRGK;
- Save the children;
- Zyra Ndërlidhëse Japoneze – Kosovë;
- Zyra e Bashkimit Europian;
- UNFPS;
- Organizata e Shëndetit Mendor.

6 SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të Sektorit tani e sa vjet;
- Numri i jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7 AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUdhËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Aktivitete për të ngritur cilësinë e shërbimeve shëndetësore.

8 TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

AKTIVITETET NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

- Trajnimi 1-mujor: “Kirurgjia e vogël dhe procedurat tjera emergjente” gjatë tërë vitit 2019 për ekipet mjekë/infermierë;
- Trajnimi 1-mujor: Trajnimi për Diabetin përgjatë vitit 2019”, në Klinikën Endokrinologjike, ekipet mjekë/infermierë;
- Më 15.01.2019, në QMU është mbajtur takimi me kordinatoren e QMU-së, i lidhur me planin e trajnimit RCP;
- Më 17.01.2019, është mbajtur takim me 3 përfaqësues të kompanisë farmaceutike “MERK” nga Maqedonia, lidhur me interesimin e tyre për organizimin e ligjëratës në QKMF, “Menaxhimi i Diabetit”;
- Nga data 21 janar, shënohet: Java Evropiane Kundër Kancerit të Qafës së Mitrës;
- Më 23.01.2019 dhe 30.01.2019, në QKMF është mbajtur ligjërata: "Imazheria e gjinjëve - Mamografia dhe modalitetet tjera", ku morën pjesë 90 mjekë;
- Më 28.01.2019, është mbajtur takim me përfaqësues të Kompanisë “NESTLE”, lidhur me ligjeratën e planifikuar me ligjërues peditër për ushqimin e foshnjeve

dhe cregullimet që shfaqen te të posalindurit, si colikat infantile, refluksi, vjelljet, etj.

- Më 31.01.2019, në QTMF është mbajtur takim me perfaqësuesit e AMF-së, lidhur me aprovimin e programit të AMFK(Asociacioni i M.Familjar të Kosovës) për ZHVVP nga OMK, si dhe kordinimin e ligjëratave të planifikuara për Komunën e Prishtinës;
- Organizata humanitare "Human Apeal Int" në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame - Prishtinë, dhuruan pajisje mjekësore - Defibrilator për nevojat e QKMF - Prishtinë;
- Përgatitje për publikim të Konkursit - pranim në marrëdhënie pune stafi QKMF;
- Më 04.02.19, AMC organizoi takimin e Komitetit të Programit për Skringun e kancerit të qafës së mitrës, ku morën pjesë anëtarët e grupit punues nga QKMF (Menaxhmenti dhe kordinatorët), me ç'rast u diskutua mbi planet për vitin 2019, si dhe për zgjerimin e programit për skringun e kancerit të qafës së mitrës në komunën e Mitrovicës;
- Takim pune, më 05. 02. 2019, lidhur me metodologjinë e auditimit "Menaxhimi i asthmës në moshat pediatrike" në Njësinë e Pediatriisë dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare. Takimi u organizua me qëllim diskutimi të metodologjisë së auditimit, rezultateve të para të cilat kanë arritur, gjendjes aktuale të të dhënave të grumbulluara;
- Në takimin e KESH-it rajonal në IKSHP, më 06.02.2019, u diskutua dhe u planifikuan aktivitetet e rradhës, si Dita Botërore e TBC-së, që daton me 24 mars;
- Në QTMF, më 07.02.2019, u mbajt takim me profesionistë gjinekologë QMG/QKMF dhe Kordinatorën e ZHVVP-se lidhur me trajnimin e Mjekëve familjarë për marrjen e PAP-testit;
- Më 07. 02. 2019, takim pune në Klinikën e Pediatriisë në SHSKUK. Në takim është diskutuar për standardizimin e menaxhimit të astmës, bazuar në evidenca më të mira, diagnostikimin, zbatimin e udhërrëfyesëve;
- Në kuadër të aktiviteteve të ZHVVP, në QKMF u mbajt ligjerata "Syndroma e zorrës irrituese (IBS)", më 13.02.2019 dhe 19.02.2019, pjesëmarrës ishin 93 jekë;
- Më 19. 02. 2019, në QKMF, komisioni shqyrtoi shkresat nga kutitë e ankesave të pacientëve. Gjithësej ishin 144 shkresa prej tyre 117 apo 81% ishin falenderime, prej tyre 113 shkresa apo 78% ishin të vlefshme, kurse 4 apo 3% ishin të pavlefshme, kurse numri total i shkresave me ankesa ishte 13 apo 9%, prej tyre 6 apo 4% ishin të vlefshëm dhe 7 apo 5% ishin jo të vlefshëm. Kurse 14 shkresa apo 10% ishin kërkesa të parashtruara nga pacientët;
- Më 27.02. 2019, në sallën e QKMF-së u mbajt ligjerata me titullin "Gripi dhe ftohja" në kuadër të programit të ligjëratave organizuar nga AMFK;
- Më 28.02.2019 u mbajt trajnim njëditor në Hotel Internacional, rreth përpilimit të materialit edukativ me rregullore të re, organizuar nga IKSHP dhe AQH; Pjesëmarrës ishin anëtarë të edukimit dhe promovimit shëndetësor nga rajoni.

- Gjatë muajit shkurt në restorant "Rings", u mbajt takim pune me anëtarët e komitetit për screeningun e Ca të qafës së mitrës, organizuar nga AMC;
- Edukim shëndetësor në SHFM të Komunës së Prishtinës, si aktivitet i rëndësishëm sipas Doracakut të Monitorimit të SSSH 2017-2021, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Nga Dita ndërkombëtare e gruas - 8 Marsi, filloi fushata sensibilizuese "Zbulimi i hershëm-Mbijetesë" e cila zgjati gjatë tërë muajit mars 2019. Në hapësirat e QKMF-së u ofruan shërbime falas të mamografisë së gjirit për gratë dhe vajzat mbi moshën 40 vjeç;
- Më 13.03.2019 dhe 28.03.2019, në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-së, në QKMF është mbajtur ligjërata "Menopauza";
- Më 20.03.2019, në QMF 9 u shënuar Dita Botërore e Shëndetit Oral, ligjeratë edukative për nxënësit e klasës së parë të SHFMU "Xhavit Ahmeti", me titull "Pastrimi dhe parandalimi i prishjes së dhëmbëve";
- Në javën e fundit të marsit, nga data 25-29.03.2019, në Qendrat e Mjekësisë Familjare u mbajtën ligjerata edukative për sëmundjen e tuberkulozit. Të pranishmëve iu shpërnda material edukativ siguruar nga IKSHP;
- Më 25.03.2019, me rastin e Ditës Botërore të Tuberkulozit, është organizuar manifestim qendror në hotelin "Sirius", ku morën pjesë jo vetëm pulmologët, por të gjithë profesionistët shëndetësorë, si dhe përfaqësues nga QKMF;
- Më 28.03.2019, në SHFMU "Meto Bajraktari" u mbajt ligjërata edukative me titull "Pastrimi i duarve dhe prevenimi nga sëmundjet ngjitëse";
- Java e imunizimit, e cila daton në javën e fundit të prillit, në tri QMF (QMF 1, QMF 6 dhe QMF 7), u shënuar me ligjërata informative për stafin, me temën "Rastet e fruthit 2017-2018 në komunën e Prishtinës";
- Më 03.04.2019, në QKMF u mbajtën ligjërata "Sëmundjet degjenerative në boshtin kurrizor" dhe "Fizioterapia të sëmundjet e boshtit kurrizor";
- Më 10 dhe 17.04. 2019, në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-së, në QKMF është mbajtur ligjërata "Mialgia-Fibromialgia";
- Më 10, 17, 24 dhe 30.04.19 në QKMF është mbajtur trajnimi: "Menaxhimi i TBC-së në KPSH". Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe menaxhim sa më cilësor të të sëmuarve me TB, DKPSH në bashkëpunim me DSHSH/Menaxheren kombëtare të tuberkulozit dhe në mbështetje të CDF-së, do të vazhdojë trajnimet me profesionistët shëndetësorë në KPSH, me ç'rast këto trajnime do të akreditohen;
- Më 16.04.2019, QMF 2 organizoi ligjërata edukative për drogat, në SHFMU "Emin Duraku";
- Më 18.04.19 në QKMF është mbajtur takim lidhur me ritrajnimin e mjekëve familjarë për marrjen e PAP-testit;
- Më 18.04.2019, në hotelin "Emerald", është bërë promovimi i Projektit për mjekimin e infarktut akut në Kosovë, ishin të ftuar mjekë familjarë nga QKMF, pasi KPSH do të jetë pjesë e këtij projekti;

- Më 18 dhe 19.04.2019, në QZHMF u mbajt trajnimi 2-ditor "Dhuna në baza gjinore". Trajnimi u mbështet nga UNDP dhe u implementua nga organizata Aksioni për Nëna dhe Fëmijë;
- Më 24.04.2019, në QTMF është mbajtur takimi me zyrtaren për mbrojtjen dhe qeverisjen e të drejtave të fëmijëve /Handikos dhe Kordinatoren e ZHVP-së/QKMF-së lidhur me Memorandumin e Mirëkuptimit. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje - HANDIKOS në bashkëpunim me QKMF-në, planifikuan që këtë vit të realizojnë së bashku implementimin e disa aktiviteteve, të cilat për qëllim kanë rritjen e ndërgjegjësimit, njohurive dhe bashkëpunimit ndërsektorial midis komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe reaguuar ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset, dhe nxitjen e llogaridhënies sociale të fokusuar tek fëmijët, për të siguruar shërbime shëndetësore cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Më 10, 11, dhe 12. 04.2019 në Hotel Internacional Prishtina, pjesëmarrje në trajnimin "Metodologjia e hartimit të udhërrëfyesve dhe protokoleve klinike", oranizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Më 25.04.2019, QMF 6 organizoi ligjëratë edukative për duhanin, në SHFMU "Ismail Qemajli";
- Më 26.04.19, në QMF 5 dhe më 30.04.2019, në QMF 6 u mbajt ligjerata "Rastet e fruthit në komunën e Prishtinës";
- Më 06.05.2019, në QKMF është mbajtur trajnimi "Menaxhimi i TBC-së në KPSH", ku morën pjesë 14 profesionistë shëndetësorë, mjek familjarë/infermiere, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, dhe për menaxhim sa më cilësor të të sëmurve me TB, DKPSH në bashkëpunim me DSHSH/menaxheren kombëtare të tuberkulozit dhe në mbështetje të CDF, do të vazhdojë trajnimet me profesionistët shëndetësorë në KPSH, me ç'rast këto trajnime do të akreditohen;
- Më 10.05.2019, në sheshin e kryeqytetit u shënuar Dita Botërore e Infermierisë. QKMF në bashkëpunim me Kolegjin UBT, qytetarëve të rastit u mundësua matja e TA, glikemisë, peshës trupore, saturimin me pulsoksimetër, dhënjën e këshillave mjekësore dhe ofrimin e materialit edukativ;
- Në QZHMF, më 13 dhe 14.05.2019, u mbajt trajnimi 2-ditor "Dhuna në baza gjinore", mbështetur nga UNDP dhe implementuar nga organizata Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, me 1 përfaqësues nga QKMF;
- Më 14.05.2019, në QMG/QKMF u mbajt takim lidhur me vazhdimin e trajnimit të mjekëve familjarë mbi marrjen e PAP-testit;
- Më, 15 dhe 22.05.19, në kuadër të aktiviteteve në ZHVP - QKMF, u mbajt ligjëratat "Infeksionet urinare te fëmijët";
- Më 16.05.19, në QTMF është mbajtur takimi i organizuar nga AMC, lidhur me organizimin e ligjëratave në komunitet për kancerin e qafës së mitrës. Në takim morrën pjesë kordinatorët e QKMF-së dhe përfaqësuesja nga AMC;
- Më 16.05.2019, QKMF në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Hendikos, u mbajt Sesioni i parë informues, me qëllim të njoftimit të profesionistëve shëndetësorë mbi llojet e aftësive të kufizuara dhe teknikat e komunikimit.

- Më 16 dhe 17. 05.2019 u organizua trajnim 1-ditor në Vila Gërmia, nga Zyra e Kryeministrit / Agjencia për barazi gjinore, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe akterët institucionalë për mbrojtje nga dhuna në familje, me temë “Procedura standarde e veprimit dhe udhërrëfytyesi mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore”;
- Më 17.05.2019, u shënuar Dita Botërore e Hipertensionit, në parkun “Gërmia”, si dhe në dy qendrat sociokulturore të të moshuarve. Gjatë aktivitetit qytetarëve dhe të pranishmëve në qendrat perkatese iu ofruan matja e TA, glikemise, peshës trupore, këshilla dhe material edukativ. Aktiviteti u mbajt në bashkëpunim me Kolegjin UBT;
- Në QZHMF, më 20 dhe 21.05.2019, u mbajt trajnimi 2-ditor "Dhuna në baza gjinore", mbështetur nga UNDP;
- Më 23.05.2019, në QKMF u organizua tryezë e rrumbullakët nga Divizioni i të Drejtave të Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor, me qëllim të prezentimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe njoftimin e profesionistëve shëndetësorë me obligimet që dalin nga ky ligj;
- Më 23.05.2019, në QMF 1 u mbajt ligjeratë edukative për komunitetin RAE, me temë “Rëndësia e imunizimit”;
- Më 24. 05. 2019, në QKMF në mbledhjen e Kolegjiut profesional, është bërë prezantimi i të gjeturave nga auditi klinik "Kujdesi shëndetësor ndaj pacientëve me astmë në Qendrat e Mjekësisë Familjare të komunës së Prishtinës, maj, 2019”. Qëllimi i auditit ishte vlerësimi i cilësisë së kujdesit ndaj pacientëve me astmë në Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunën e Prishtinës; identifikimi i mangësive dhe zbatimi i masave përmirësuese;
- Më 24.05.2019, Diakonie Kosova, Qendra Psikosociale për Traumatërapji, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temën “Trajtimi i traumës në shoqërinë Kosovare, sfidat dhe perspektiva”;
- Në QTMF, më 27.05.19, u mbajt takim me kordinatoren e K 10 dhe kordinatoren e ZHVP-së lidhur me organizimin dhe kordinimin e datave rreth vazhdimit të trajnimit: Dhuna në baza gjinore”, i cili është duke u mbajtur në QZHMF në nivel vendi;
- Më 28.05.2019, në Hotel International Prishtina në Prishtinë është mbajtur punëtorja njëditore “Monitorimi dhe vlerësimi (M&E) i planeve të veprimit” i orientuar dhe bazuar në Doracakun e monitorimit dhe vlerësimit të SSSH-së 2017-202, organizuar nga AQH-së, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë. Punëtorja është mbajtur nga Kompania ARS;
- Më 30. 05. 2019, në IKSHP pjesëmarrje në ligjeratën “Menaxhimi i rasteve me TB, metodat e reja të diagnostikimit dhe roli i tyre në algoritmin diagnostik”;
- Më 30.05.2019, në QKMF u mbajt “Sesioni informues për promovimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje të fëmijëve nga dhuna në familje” organizuar nga Hendikos;
- Më 31.05.2019, u shënuar Dita Botërore Kundër Duhanit, me c'rast një numër i madh i studentëve të UBT-së, mbajtën aktivitet në shesh, duke u ofruar molla qytetarëve, me

moton "Jeto shëndetshëm, Jo duhanit". Gjitashtu, u shpërnda edhe materiali edukativ për pasojat e duhanpirjes;

- Në QZHMF, më 06 dhe 07.06.2019, u mbajt trajnim 2-ditor "Dhuna në baza gjinore", mbështetur nga UNDP dhe implementuar nga organizata Aksioni për Nëna dhe Fëmijë;
- Më, 06.06.19, në restorantin "Rings", takim me anëtarët e Komitetit të Programit për Skriningun e Kancerit të Qafës së Mitres, organizuar nga AMC, ku u diskutua për progresin e deritashëm dhe aktivitetet e planifikuara të Programit;
- Në SHFMU "Ismail Qemajli", më 06.06.2019, është mbajtur ligjërata "Parandalimi i kancerit të qafës së mitres", për stafin e shkollës, organizuar nga AMC;
- Më 11.06.2019, në shkollën "Hasan Prishtina" u mbajt ligjërata edukative "Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës", për stafin e shkollës, organizuar nga AMC;
- Në kuadër të aktiviteteve të ZHVVP-së, më 12 dhe 19.06.2019, në QKMF është mbajtur ligjërata "Laringitis acuta";
- Më 14.06.2019, komisioni i përbërë nga pesë anëtarë: personel shëndetësor – QKMF dhe përfaqësuese e Sindikatës në QKMF – Prishtinë, analizuan shkresat nga 20 kuti të ankesave nga muaji shkurt deri në maj të vitit 2019. Nga gjithsej 57 shkresa të analizuara, 47 ishin shkresa të vlefshme. Totali i shkresave falënderuese ishte 50-të, prej tyre 43 apo 91% shkresa falenderuese të vlefshme, kurse 7 shkresa apo 12% shkresa falenderuese jo të vlefshme, ndërsa 3 shkresa apo 6% ishin ankesa të ndryshme të qytetarëve, të cilat u shqyrtuan nga ana e komisionit, dhe 3 shkresa apo 6% ankesa të pavlefshme. Një shkresë ishte kërkesë e qytetarit. Vlefshmëria e shkresave është bazuar nga të dhënat: emri, mbiemri, ID, numri i telefonit apo adresa e qytetarit;
- Më 17 dhe 18.06.2019, në QZHMF është mbajtur trajnimi 2-ditor "Dhuna në baza gjinore", mbështetur nga UNDP dhe implementuar nga organizata Aksioni për Nëna dhe Fëmijë;
- Në Holiday Resort, më 19 dhe 20.06.2019, u mbajt Konferenca përgatitore për ushtrim fushor MISP 2019;
- Më 21.06.2019 nga ora 12.00-13.00, në sallën e bibliotekës së QZHMF-së, takim pune i grupit punues për hartimin e udhërrëfyesit "Menaxhimi i Infeksionit Latent të TB", organizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Më 24.06.2019, nga ora 11:00 në RIT Kosovo (AUK – Gërmia) pjesëmarrje në trajnim mbi Regjistrin elektronik për TB (SIM - TB), organizuar nga OJQ KeA;
- Më 28.06.2019, nga ora 12.00-13.00, në sallën e bibliotekës së QZHMF-se, takim i dytë i grupit punues për hartimin e Udhërrëfyesit linik "Menaxhimi i infeksionit latent të TB", organizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Gjatë takimit u diskutua për qëllimin, metodologjinë, pyetjet shëndetësore, si dhe grupi u përcaktua të marrë për bazë shqyrtimin e materialeve nga Udhërrëfyes të OBSH, CDC, si dhe Udhërrëfyes nga rajoni si Shqipëria dhe të grumbullohen hulumtime

vendore nga Kosova për Menaxhimin e ILTB dhe Tuberkulozit Etra Pulmonar. U ndanë detyrat dhe afatet kohore të hartimit të draftit;

- Më 04.07.19, në QKMF në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Hendikos, është mbajtur Sesioni i dytë informues, me qëllim të njoftimit të profesionistëve shëndetësorë mbi llojet e aftësive të kufizuara dhe teknikat e komunikimit. Pjesëmarrës përveç profesionistëve shëndetësorë, morën pjesë edhe 3 prindër të personave me aftësi të kufizuara;
- Më 11. 07. 2019, takim pune në QKMF, u diskutua për fillimin e hulumtimit " Opinioni i pacientëve me Sëmundje të Diabetit për Kujdesin Shëndetësor, i cili ofrohet në Qendrat e Mjekësisë Familjare në komunën e Prishtinës";
- Më 12. 07. 2019, nga ora 12.00-14:00 në sallën e bibliotekës së QZHMF-së, është mbajtur takimi i tretë i grupit punues për hartimin e Udhërrëfyesit klinik "Menaxhimi i Infeksionit Latent të TB", organizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Takimi u zhvillua me përmbajtjen si vijon:
 - U prezantuan draftet e para të Udhërrëfyesit bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara. Materialet e grumbulluara janë të bazuara në Udhërrëfyesit ekzistues për Menaxhimin e ILTB të OBSH, CDC, dhe Udhërrëfyesit nga Shqipëria. Gjatë hartimit të udhërrëfyesit pyetjet janë përzgjedhur sipas PICO formatit dhe është punuar sipas instrumentit Agree: hyrja e udhërrëfyesit, qëllimi dhe fokusimi, të dhënat epidemiologjike, popullata e synuar, dedikimi i udhërrëfyesit, metodologjia, burimet e adaptimit të udhërrëfyesit, grada e rekomandimeve dhe niveli i evidencave.
- Më 18. 07. 2019, është punuar raporti për tremujorin e parë (janar - mars 2019) " rasteve të reja dhe të ritrajuara me rezistencë (GeneXpert dhe Rezistence ne Kulture)" nga DSM Prishtinë. Numri total i rasteve të TB me rezistencë të bërë me cilëndo nga ty metodat (ose me Xpert, ose me rezistencë në kulture, ose me të dyjat) për tremujorin e parë është 23 raste;
- Më 29.07.2019, në QKMF është mbajtur takim lidhur me Ritrajnimin e mjekëve familjarë për marrjen e Pap-testit, filluar më 21.05.19 dhe i cili do të vazhdojë deri më 31.08.19;
- Më 30. 07. 2019, është punuar Raporti për tremujorin e parë, Q 1, (janar - mars 2019) dhe tremujorin e dytë, Q 2, (maj - qershor, 2019) rasteve të reja dhe të ritrajuara me rezinstencë në DSM Prishtinë. Rezultatet e raportit janë: numri i pacientëve me sëmundje aktive të TB Pulmonar, të konfirmuar bakteriologjikisht (BK+, Xpert+, kulturë+) është 12, Pulmonar, të diagnostikuar klinikisht (BK -, Xpert -, kulturë -, ose fare nuk është bërë mikrobiologjia) është 35 raste, Ekstrapulmonar, të konfirmuar bakteriologjikisht (BK+, Xpert+, kulturë+) është vetëm 1 rast, Ekstrapulmonar, të diagnostikuar klinikisht (BK -, Xpert -, kulturë -, ose fare nuk është bërë mikrobiologjia) janë 14 raste. Totali i pacientëve për dy kuartat Q 1 dhe Q 2 (janari - qershor 2019) është 124;
- Më 31. 07. 2019 nga ora 12.00-13:30 në QZHMF është mbajtur takimi i katërt i grupit punues për hartimin e Udhërrëfyesit klinik "Menaxhimi i

Infeksionit Latent të TB", organizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Grupi punues prezantoi draftin e parë të Udhërrëfyesit klinik;

- Më 04.08.2019, në QKMF në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Hendikos, është mbajtur Sesioni i dytë informues, me qëllim të njoftimit të profesionistëve shëndetësorë mbi llojet e aftësive të kufizuara dhe teknikat e komunikimit. Pjesëmarrës përveç profesionistëve shëndetësorë, muarrën pjesë edhe 3 prindër të personave me aftësi të kufizuara;
- Më 06. 08. 2019, takim pune në sallën e konferencës në Hotel Sirius, nga ora 09:30 deri 14:00 për Raportim Online të Databazës për Kosovën në WHO-TB;
- Më 28. 08. 2019, pjesëmarrje në trajnimin dyditor për psikometri prej orës 09:00-15:00 në QZHMf. Qëllimi i trajnimit: Ngritja e kapaciteteve për psikometri;
- Më 11 dhe 18.09.2019 është mbajtur ligjërata: Syndroma e lodhjes kronike;
- Më 12, 19 dhe 23.09.2019, është mbajtur trajnimi 3-ditor ToT - "Përfshirja e burrave dhe grave në barazi gjinore", organizuar nga PEN-(Peer Educators Network);
- Më 16, 20, 24, dhe 27.09.2019, në kuadër të Projektit për mjekimin e infarktit akut në Kosovë, janë mbajtur ligjëratat për Trajtimin e hershëm të Infarktit të Miokardit;
- Më 17.09.2019, në "Hotel Internacional Prishtina" në Veternik, pjesëmarrje në takimin e profesionistëve shëndetësorë rreth situatës me fruth në Kosovë dhe Evropë, të organizuar nga IKSHPK, në bashkëpunim me OBSH dhe MSH;
- Më 19.09.2019, është mbajtur takim pune në Hotel Nartel me Grupin punues për hartimin e SOP "Përcaktimi i kriterëve për qëndrimin e pacientëve me TB në institucionet shëndetsore në KDSH dhe KTSH";
- Më 24.09.2019, u mbajt takim pune me Menaxhmentin e QKMF- së dhe anëtarët nga Drejtoria e Shëndetësisë, lidhur me organizmin e aktiviteteve për muajin e luftës kundër kancerit të gjirit, ku më 26 shtator filloi ligjerata edukative për komunitetin RAE në QMF 1, si dhe u ftuan gratë për mamografi ditën, më 30 shtator. Aktiviteti vazhdon tutje gjatë muajit tetor;
- Më 25 dhe 26.09.2019 në QKMF, në kuadër të aktiviteteve të planifikuara nga Hendikos, janë mbajtur "Sesionet informuese për promovimin e procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje të Fëmijëve nga dhuna në familje" organizuar nga Hendikos;
- Më 25.09.2019, Drejtori/SHSKUK dhe Drejtori/KE, nëshkruan certifikatat për periudhën maj/2018 deri në mars /2019, për ekipet mjekë/infermierë, të cilët vijuan trajnimin "Kirurgjia e vogël dhe procedurat tjera emergjente", me kohëzgjatje 1-mujore;
- Më 25. 09. 2019 në sallën e bibliotekës së QZHMf-së, është mbajtur takim i grupit punues për hartimin e Udhërrëfyesit klinik "Menaxhimi i infeksionit latent të TB" organizuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Më 26.09.2019, u mbajt ligjeratë edukative në SHFMU "Mati Logoreci" në Prizren, "Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës";

- Më 27.09.19, në kuadër të planprogramit për Skriningun e Kancerit të Qafës së Mitrës, është mbajtur ligjerata për Pap-test në SHF "Emin Duraku" në Prizren, organizuar nga AMC;
- Nga 30.09.2019 deri më 02.10.19, në QZHMF vijoi trajnimi 3-ditor për Planifikim familjar, organizuar nga AMC në bashkëpunim me MSH, UNFPA dhe akredituar nga OMK;
- Më 30.09.19, është mbajtur takimi i Komitetit të Programit për Skriningun e Kancerit të Qafës së Mitrës, në restorant "Rings", organizuar nga AMC (Akcioni për Nëna dhe Fëmijë);
- Më, 30.09.19, u shënuar Dita Botërore e Zemrës, me aktivitete për pacientë në hyrje të QKMF-së, duke ofruar shërbime shëndetësore, si matja e TA, vlerat e pulsoksimetrit, pesha trupore, si dhe materiali edukativ;
- Më 30 .09.2019, u mbajt takim pune, organizuar nga AMC, me ç'rast u diskutuan hapat e mëtejme të programit nacional rreth realizimit të pap testit në komunën e Prishtinës;
- Në kuadër të pakos bazike, u mbajtën ligjërata edukative në shkolla me temën: Dhuna në shkollë dhe bulizmi:
 - 11 shtator 2019, ligjerata në SHFMU "7 Marsi" nga QMF7;
 - 23 Shtator 2019, ligjërata në SHFMU "Ismail Qemajli" nga QMF6, " Mehmet Gjevori" nga QMF8 dhe " Xhavit Ahmeti" nga QMF9;
 - 25 Shtator 2019, ligjerata në SHFMU "Pavaresia" nga QMF Mati 1;
 - 26 Shtator 2019, ligjërata në SHFMU "Hilmi Rakovica" nga QMF2;
 - 27 shtator 2019, u organizua vizitë në QKMF nga nxenesit e SHFMU "Mehmet Gjevori";
- Më 01, 04, dhe 08.10.2019, në QKMF në kuadër të Projektit për mjekimin e infarktut akut në Kosovë, janë mbajtur ligjëratat - Trajtimi i hershëm i infarktut të Miokardit;
- Më 04.10.2019 në hotelin "Nartel", duke filluar nga ora 10:00, takim pune organizuar nga OJQ KeA "Punëtorinë mbi rrugën e referimit të pacienteve të TB sipas qasjes me fokus pacientin e TB, së bashku me kriteret e hospitalizimit dhe lëshimit nga spitali, të dizajnuara dhe inkorporuara në udhëzuesit e PKKT";
- Më 08.10.2019, intervistim për radio, me qëllim të edukimit dhe promovimit shëndetësor për sëmundjen e gripit;
- Më 09 dhe 16.10.2019, u mbajt ligjerata: Abuzimi me substanca narkotike;
- Më 15.10. 2019, trajnim stafi " Analizimi dhe interpretimi i të dhënave nga fusha e monitorimit dhe vlerësimit të TB-së, si ndihmë për informim dhe vendimmarrje". Trajnimi u mbajt nga ekspert të njohur të WHO-se në fushën e Epidemiologjisë dhe te M&V;

- Më 16.10.2019, takim pune në Ministrinë e Shëndetësisë, në Divizionin e Farmacisë, me qëllim të identifikimit të barërave për KPSH nga Lista e re e barërave esenciale, për të vazhduar më 18.10.19 me grupin punues QKMF;
- Më, 21.10.19 deri më 23.10.19 në QZHMF u mbajt Trajnimi 3-ditor për IST;
- Më 22.10.2019, takim pune me anëtarët e grupit punues nga qyteti i Gjilanit dhe Drenasit, për finalizimin e punës në përzgjedhjen e barërave për KPSH nga Lista e re e barërave esenciale;
- Më, 23.10 dhe 30.10.19 në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-së, në QKMF është mbajtur ligjërata: Vertigo;
- Më 25.10.2019, Dispanseri i Sëmundjeve të Mushkërive në komunën e Prishtinës është vizituar nga ekspertja e Bankës Botërore, Znj.Marian Thivezert, Menazheri Kombëtar i Tuberkulozit, Dr. Majlinda Gjocaj dhe përfaqësuesi i OBSH-së, Dr. Gazmend Zhuri. Gjatë takimit u diskutua e gjithë procedura e kujdesit të pacientëve me tuberkuloz në ordinancat e mjekëve, sportel, laborator, dhe regjistri i përpunimit të kontaktit, SIM TB, ruajtja e të dhënave, raportimi i rregullt sipas kuarteteve në Programin Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit, ku u verifikua edhe besueshmëria e raportimit;
- Nga 01.10.2019 deri më 31.10.19, trajnimi për Dijabetin është duke vazhduar në Klinikën Endokrinologjike, me kohëzgjatje 1-mujore;
- Më 30.10.19, në SHFMU "Asim Vokshi" në Prishtinë në kuadër të "Tetori - muajii vetëdijesimit për luftë kundër kancerit" u organizua ligjerata: Parandalimi i kancerit të gjirit;
- Më 31.10.19, në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-se për Shërbimin Stomatologjik në QKMF, u mbajt ligjerata: Mungesa e Vit D;
- Java e gjidhënjes u shënua me aktivitete në këto qendra:
 - 01 tetor 2019, në QKMF (pediatri dhe vaksinim),
 - 02 tetor 2019, në QMF 1,
 - 03 tetor 2019, në QMF 11 dhe QMF Mat,
 - 04 tetor 2019, në QMF 7;
- Ligjëratat edukative mbi zbulimin e hershëm të Ca të gjirit dhe rëndësinë e mamografisë, u realizuan në:
 - 26 shtator, në QMF 1 për gratë e komunitetit RAE;
 - 30 shtator, në QMF Besi për gratë e fshatit Besi dhe Bardhosh;
 - 02 tetor, në QMF Hajvali për gratë e fshatit Hajvali dhe Mramor;
 - 04 tetor në AMB Keqekolle, për gratë e fshatit Keqekolle;
- Nga 30 shtator deri më 07 tetor, në QKMF/ mamografi mobile, u realizua mamografia për rreth 50 gra, që ka rezultuar me zbulim të një rasti me malinjitet;
- Në vazhdimësi gjatë tërë muajit tetor, të gjitha QMF-të mbajtën ligjërata edukative për Kancerin e gjirit brenda QMF-ve për pacientët e tyre;
- Pakoja bazike në shkolla:
 - 02 tetor, QMF 9 u vizitua nga nxënësit e SHFMU "Xhavit Ahmeti";

- Më 2 tetor, QMF 6 mbajti ligjëratë edukative për nxënës, me temën: Bulizmi në SHFMU "Ismail Qemajli";
- Më 08 tetor, QMF 1 mbajti ligjërate edukative për nxënës, me temën: Aksidentet rrugore, në SHFMU "Emin Duraku";
- Më 10 tetor, QKMF mbajti ligjëratë edukative për nxënës, me temën: Bulizmi, në SHFMU "Qamil Batalli";
- Më 15 tetor, QMF 1 mbajti ligjëratë edukative për nxënës, me temën: IST, në SHFMU "Emin Duraku";
- Më 30 tetor, QMF 1 mbajti ligjëratë edukative, me temën: HIV-AIDS, në SHFMU "Emin Duraku";
- Më 1 tetor, QMF në Hajvali mbajti ligjëratë edukative për Sëmundjet kardiovaskulare;
- AMC në bashkëpunim me QKMF, realizoi ligjëratë edukative për "Ca e qafës së mitrës" në qytetin e Mitrovicës";
- Më 21 tetor, në SHFMU "Fazli Grajqevci" dhe më 23 tetor, në SHFMU "Migjeni";
- Gjatë muajit tetor u realizuan dy emisione televizive në RTK - Imazh, njëra për Ca e gjirit dhe, e dyta, për rëndësinë e imunizimit me pjesëmarrës nga QKMF;
- Më 01.11.19, në QKMF u mbajt takim së bashku me perfaqesuesen e Shoqatës së Kirurgëve Plastikë, ku u diskutua lidhur me Trajnimin: "Metodat bazike dhe bashkohore për trajtimin e djegieve", i cili u mbajt më 12, 19 dhe 26 nëntor 2019 në QKMF. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është njoftimi i stafit mjekësor, me metodat bazike bazuar në protokollin e reja për trajtimin e djegieve. Trajnimi është akredituar nga OMK dhe planifikohet të mbahet çdo të martë derisa të përfshihen të gjithë mjekët nga QKMF;
- Më 12 dhe 13.11.2019 në punëtori perfundoi përpunimi - materiali për udhërfyjesin e TBC ekstrapulmonare, e cila u dorëzua në MSH;
- Më 12, 13 dhe 14.11. 2019, duke filluar prej orës 9:30 deri në orën 15:00, në hotel "Prishtina Internacional" është mbajtur takim pune për finalizimin e draftit për Udhërfyjesin klinik "Menaxhimi i infeksionit latent të tuberkulozit". Drafti i finalizuar i Udhërfyjesit është përgatitur për dorëzim në Këshillin Kosovar për UK dhe Komisionin për Vlerësimin e Metodologjisë në MSH. Literatura për adaptimin e Udhërfyjesit "Menaxhimi i infeksionit latent" është adaptuar nga udhërfyjesit e OBSH-së, CDC, Stop Partnership dhe udhërfyjesit e rajonit;
- Më 13, 14 dhe 15.11.2019, në QZHMF është mbajtur trajnimi 3-ditor për IST, ku nga QKMF janë ftuar të marrin pjesë një mjek dhe një infermier. Trajnimi është organizuar nga AMC, në bashkëpunim me MSH, UNFPA dhe është akredituar nga OMK;
- Më 13 dhe 20.11.19, në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-së, në QKMF u mbajt ligjerata: "Bronchiolitis";
- Më 31.10 dhe 01.11.2019, QMF "Mati 1" mbajti aktivitet dyditor, me ligjeratë edukative me temën: "Drogat", në SHFMU "Pavarësia", për klasat e larta;

- Më 14.11.2019, u shënua Dita Botërore e Diabetit në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare të komunës së Prishtinës. Me këtë rast u mbajtën aktivitete, përfshirë ligjerate edukative, matje e glikemise, matje e TA, këshilla, si dhe shpërndarje e materialit edukativ për pacientët me diabet. Nga donacionet u furnizua QKMF me disa glikometra dhe shirita matës që shërbyen për realizimin e aktivitetit në 3 qendrat e takimit ditor të të moshuarve në lagjet “Xhamia e Llapit”, “Aktash” dhe “Pejton”, në po të njëjtën ditë;
- Më 15.11.2019, raportim në PKKTB për TM II (prill - qershor 2019) për të gjitha rastet e reja dhe ritrajtuara me rezistencë të bërë (GeneXpert dhe Rezistencë në Kulturë) - në DSM Prishtinë;
- Dita kunder HIV-AIDS, u mbajt në mënyre kontinuele në SHFMU;
- Më 03 dhe 10 dhjetor 2019, në QKMF u mbajt trajnimi: "Metodat bazike dhe bashkëkohore për trajtimin e djegieve" organizuar nga Shoqata e Kirurgeve Plastik Rekonstruktiv të Kosovës;
- Më 11 dhe 13.12.2019, ne Hotel Sirius u organizua konferencë/punëtori për përmirësimin e cilësisë: “Mbështetja në të ushqyerit me gji”, nëpër QMF në kuadër të hulumtimit të znj. Melinda McKay nga Londra, rreth përmirësimit të cilësisë në KPSH. Konferenca u mbështet nga OBSH dhe u implementua nga AMC dhe QKMF;
- Më 11 dhe 18.12.2019, në kuadër të aktiviteteve të ZHVP-së në QKMF, u mbajt ligjerata: "Osteoarthritis";
- Më 17.12.2019, në QKMF u mbajt takim nga HANDIKOS, lidhur me vazhdimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2020, të cilat kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, njohurive dhe bashkëpunimit ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset, si dhe sigurimin e shërbimeve shëndetësore cilësore për këta fëmijë;
- Më 20.12.19, u mbajt takim i Komitetit të Programit për Skriningun e Kancerit të Qafës së Mitres, organizuar nga AMC;
- Raport për rezultatet e trajtimit TB 2018 në DSH të komunës së Prishtinës;
- Raport mujor, Raport i barnave ATL në DSH, Komuna e Prishtinës.

Në kolegjiunet profesionale gjatë periudhës raportuese u shqyrtuan këto tema:

- Raporti i shqyrtimit të kutive të ankesave;
- Prezentimi i punës së DAT;
- Prezentimi i aktiviteteve të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, të realizuar në vitin 2018 dhe planit për vitin 2019;
- Prezentimi i të gjeturave të studimit të mënyrës së të jetuarit të punonjësve të shëndetësisë së KPSH-së në Prishtinë;
- Prezentimi i rezultateve të mamografisë mobile;
- Raportimi i shefave për QMF dhe AMF për TM 3;
- Prezentimi i auditit të menaxhimit të astmës në KPSH;
- Të ndryshme.

- QKMF siguroi transportin e 64 pacientëve nga shtëpitë e tyre në QKUK – Hemodializë;

Njësia e vaksinimit

- Bazuar në kalendarin e Imunizimit, u vaksinuan 3382 nxënës, të klasave të dymbëdhjeta, me vaksinë Td në ShML të shkollave: “Sami Frashëri”, “Ahmet Gashi”, “Gjin Gazulli”, “7 Shtatori”, “Alaudin”, “28 Nëntori”, “Eqrem Çabej”, “Hoxhë Kadri Prishtina”, “Shtjefën Gjevori”, “Ali Sokoli”, “Prek Jakova”, “Abdyl Frashëri”, “Xhevdet Doda”, SHML “Don Bosko”; “Mileniumi i Tretë”, “Arsimi i Shqipërisë”; “Prishtina High School”; “Rezonanca”; “American School of Kosova”; “The British School” dhe “Zenit”; ndërkaq 814 nxënës të klasave të pesta dhe të gjashta në SHFMU: “Meto Bajraktari”, “Naim Frashëri”, “Hilmi Rakovica”, “Elena Gjika”, “Hasan Prishtina”, u vaksinuan me Dt-AL,MMR, OPV;
- Fëmijë të përfshirë në vaksinim sipas kalendarit të imunizimit, në vitin 2019 ishin 17910, përderisa 10750 qytetarë u vaksinuan me vaksinën e gripit në muajin dhjetor 2019.

Pako bazike e edukimit në shkolla:

QKMF – Ligjëratë eduaktive në SHFMU "Meto Bajraktari", me temën "Duhani, droga dhe alkooli";

Ligjeratë eduaktive vetëm për duhanin në Ditën Botërore Kundër Duhanit;

QMF1 - Ligjeratë eduaktive në SHFMU "Emin Duraku", me temën "Aktiviteti fizik";

QMF 4 - Ligjeratë eduaktive në SHFMU "Nazim Gafurri", me temën " Parandalimi i dhunës";

Ligjëratë eduaktive, me temën " Aksidentet rrugore";

Ligjëratë eduaktive, me temën "Sëmundjet seksualisht transmise";

Ligjëratë eduaktive, me temën " Duhani dhe droga".

Poliklinika stomatologjike

- Furnizim me material shpenzues stomatologjik nga OE;
- Funkcionalizim i ordinancës stomatologjike – QMF 3;
- PKS u vizitua nga:
 - MSH dhe QKSUK, ku është diskutuar mbarëvajtja e punës në Poliklinikën stomatologjike;
 - Nxënësit e SHMU “Dardania” në Shërbimin stomatologjik, QMF V;

- Në kuvendin e Odës së Stomatologëve janë zgjedhur 4 përfaqësues nga Shërbimi stomatologjik, trajnohet stafi nga ana e OE;
- Për nder të Ditës Botërore të Shëndetit Oral, u mbajtën aktivitete (ligjërata dhe bashkëbisedim) me fëmijët parashkollor në 5 çerdhe të komunës së Prishtinës;
- Trajnim i asistentëve të stomatologjisë, bazuar në konkursin e fundit;
- Vizita stomatologjike në Institucionin parashkollor “Zogjtë” në Sofali;
- Punime rreth plotësimit të Projektudhëzimit administrativ;
- Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi në mes DSH-së dhe Qendrës për Këshillim Profesional, që nxënësit e SHM “Dr. Ali Sokoli” - pjesë praktike në Poliklinikën stomatologjike - QKMF Prishtinë;
- Trajnimi i punëtoreve të Poliklinikës stomatologjike për SISH;
- Adaptimi i hapësirës për vendosje të pajisjes – Ortopan;
- Planifikim mbi materialin shpenzues stomatologjik, përfshirë edhe shërbimet radiologjike – filma retroalveolar për vitin 2020.

➤ Për këtë periudhë kohore janë pranuar/furnizuar Barnatorja Qendrore:

- Donacione:
 - Pharma Plus - Losarcomp Genericon 50mg-12.5mg, sasia 100 kuti;
 - Santefarm, me material ampular, dhe Trepharm, me material tabletar dhe sirupa;
 - Santefarm, me Lysobact.sprey dhe material ampular;
 - Pharma Plus, me produkte tabletare;
 - Sinorg, me produkte tabletare dhe ampullare;
- Nga Ministria e Shëndetësisë, furnizime nga lista esenciale me material tabletar, medicinal shpenzues dhe material ampullar;
- Sipas kontrave aktive furnizime nga:
 - OE “Koslabor”, me material medicinal shpenzues – 22 dhe 24.07.19;
 - OE “Sinorg” me material tabletar dhe ampullar – 24.07.19;
 - OE NSHT “Made Kos”, me material medicinal shpenzues – 16.08.19;
 - OE “Lego” SHPK, me material tabletar dhe ampullar – 16.08.19;

➤ Vizitat dhe shërbimet shëndetësore të ofruara në QKMF dhe njësitë e saj

- Viz. mjekësore – 1114542;
- Shër. shëndetësore – 740957;
- Shër. laboratorike – 976750;
- Shër. stomatologjike – 200698;
- Shër. radiologjike – 21158;
- Gjithsej – 3054105.

AKTIVITETET NË QENDRËN E MJEKËSISË URGJENTE

Gjatë periudhës raportuese është punuar me ekipe mjekësore sipas orarit të punës. Gjatë 24 orëve, mesatarja ishte rreth 130 shërbime shëndetësore. Mesatarja e intervenimeve në terren ishte 40 deri 50 raste për 24 orë. Shërbimet janë kryer sipas proriteteve të triazhës për ndihmë mjekësore. Nga raportimet e mëngjesit nga stafi mjekësor të gjitha rastet urgjente janë trajtuar.

Sipas raporteve mjekësore, kanë dominuar rastet me:

- Sëmundje akute respiratore;
- Astma bronchiale;
- Gjendjet febrile;
- Bronchitet kronike;
- Lëndime në aksidentet e trafikut;
- Hipertension arterial;
- Abdomeni akut;
- Lëndimet e papritura nga rrëshqitjet;
- Neurozat;
- Sindromi apstinencial nga përdoruesit e drogave;
- Krizat e vetëdijes etj.

Vizitat shëndetësore vazhduan sipas thirrjeve në linjen tel.194 në Qendrën Dispiqerike nga qytetarët.

- Mjekët dhe infermierët e Qendrës së Mjekësisë Urgjente, trajnohen për programin nacional të trajtimit të infarktut akut të miokardit – QMU.
- Inagurohet Pllaka memoriale “Dr. Faton Hoxha”, më 29.03.2019, në hapësirën e QMU-së.

Si gjithnjë, ekipet mjekësore ishin të mobilizuara për ofrimin e interevenimeve urgjente, përkunder kushteve të vështira atmosferike nga sasia e madhe e dëbores, akullit, temperaturave shumtë të ftohta, por edhe gjatë stinës së verës me temperature të larta. Gjatë stinës së dimrit, tek raportet mjekësore vërehet një rritje e pacientëve me sëmundje akute respiratorë, të shoqëruara me rritje të temperatures trupore dhe kollitje gjatë muajve janar – mars 2019, përderisa gjatë temperaturave të larta dominon barkqitjet dhe të vjellurat.

- Bazuar në Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, në bazë të Ligjit për shëndetësi dhe Ligjit për veteqeverisje lokale, komunat janë përgjegjëse për asistim të bashkëatdhetareve të riatdhesuar:

- Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, më 17.01.2019; 14.03.2019, 14.10.2019 dhe 12.12.2019.

- Më 16, 17.01.2019, QMU është vizituar nga ekspertët suedezë. Kordinatorja për EVM dhe grupi punues me stafin shëndetësor, mbajtën aktivitet ditor lidhur me implementimin e udhërrefyesëve klinik në

- praktikë. Aktiviteti është monitoruar nga ekspertë suedezë, të cilët e kanë vlerësuar lart qasjen profesionale të stafit, si dhe organizimin;
- Më 25.01.2019, nga ora 8:10 deri 9:15, është mbajtur Kolegjiumi mjekësor, ku është diskutuar lidhur me raportin vjetor për shërbimet mjekësore të QMU-së. U zhvilluan diskutime konstruktive, duke pasur në fokus përmirësimet në periudhën e ardhshme;
 - Më 01.02.2019, ekipi mjekësor me autoambulancë ka filluar punën në punktin pranë QKMF-së, në të cilin do të punohet sipas orarit të punës, non-stop 24 orë. Qëllimi i hapjes së kësaj pike është ofrimi i intervenimeve të shpejta, duke shkurtuar kohën e intervenimeve për shkak të trafikut të dendur në qytet;
 - Më 14.03.2019, një ekip mjekësor nga QMU-ja, asistoi në Aeroportin Ndërkombëtar „Adem Jashari” - “Riatdhesim i qytetarëve të Kosovës”;
 - Më 24.03.2019, një ekip mjekësor nga QMU-ja tregoi gartishmëri të ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë mbarëvajtjes së minimaronës 5 km, organizuar nga OJQ "Replay Peace" në Hajvali, me moton - Vrapo për paqe, duke filluar nga ora 12.00 - 15.00;
 - Më 20.03.2019, prej orës 16:30, asistoi gjatë stërvitjes së kombëtares së Kosovës, e mbajtur në stadiumin e qytetit “Fadil Vokrri”;
 - Më 20.03.2019, nga ora 18:00, i njeiti ekip ka siguruar stërvitjen e kombëtarës së Danimarkës në stadiumin e qytetit “Fadil Vokrri”;
 - Më 21.03.2019, nga ora 17:00 deri 22:30, ndeshja Kosova - Danimarka, u sigurua nga dy ekipe mjekësore me autoambulanca. Ndeshja është luajtur në stadiumin e qytetit “Fadil Vokrri”;
 - Më 24.03.2019, një ekip mjekësor i QMU-së, siguroi stërvitjen e Kombëtares së Kosovës në stadiumin e qytetit të Prishtinës “Fadil Vokrri”;
 - Më 25.03.2019, nga ora 17:00 deri në ora 22:30, dy ekipe nga QMU-ja me autoambulanca u sigurua ndeshja zyrtare e kombëtareve, Kosovë - Bullgari, e luajtur në stadiumin e Prishtinës “Fadil Vokrri”;
 - Më 29.03.2019, ekipi mjekësor nga QMU mori pjesë në ushtrimin e shpëtimit dhe evakuimit organizuar nga KOST-i. Ushtrimi zgjati nga ora 10:00 deri 14:00;
 - Më 31.03.2019, nga ora 10:00 deri 15:00, një ekip mjekësor i QMU-së, siguroi garën e çiklizmit në maratonën për kupën e Prishtinës, të mbajtur në relacionin Llukar - Keqekoll - Ballaban - liqeni i Batllavës;
 - Më 08.04.2019, një ekip mjekësor nga QMU-ja, siguroi ndeshjen futbollistike të femrave të kombëtareve Kosovë-Maqedoni Veriore në stadiumin “Fadil Vokrri”;
 - Më 18/19.04.2019, një ekip mjekësor i QMU-së, siguroi aktivitetin e rekrutimit të vajzave të reja në futboll, aktiviteti është mbajtur në stadiumin “Ramiz Sadiku”;

- Më 19.04.2019, ekipi mjekësor me autoambulancë mbështeti Festivalin e organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës në arsimin parashkollor, i cili zgjati nga ora 10:00 deri 15:00 dhe është mbajtur në stadiumin “Fadil Vokrri”;
- Më 23.04.2019, një ekip nga QMU-ja siguroi ushtrimin e reagimit ndaj termetit, që është mbajtur në shkollën „Naim Frashëri”;
- Sigurimi i maratonës së shkollave të Prishtinës, të mbajtura më 24.04.2019 afër Fakultetit Teknik;
- Sigurimin e protestës paqësore para Prokurorisë, të organizuar nga subjekti politik “Vetëvendosje”, e mbajtur më 26.04.2019;
- Sigurimi i garave ndërkombëtare, “Prishtina International Half-Marathon”, më 4 ekipe mjekësore, e mbajtur më 28.04.2019;
- Më 01.05.2019, ekipi mjekësor ishte në shërbim të qytetarëve me rastin e protestës paqësore, e cila është mbajtur para Qeverisë, për të drejtat e punëtorëve në punë; Po e njëjta ekipë vazhdoi kujdestarinë në Parkun e Gërmisë në sigurimin e qytetarëve vizitor nga mbar Kosova;
- Më 10.05.19, nga ora 10:00, u asistua me një ekip mjekësore me autoambulancë, në aktivitetin e Krosit Republikan, që është mbajtur në Prishtinë, në "Parkun e Gërmisë"; përderisa u vazhdua nga ora 12:00, sigurimi i ngjarjes me pjesëmarrje të 13 shkollave fillore dhe të mesme të ulta të komunes së Prishtinës lidhur me sigurin në rrugë. Garat këto të mbajtura me organizimin e Kolegjit të Shkencave të Aplikuara Teknike “Tempulli” në sheshin “Zahir Pajaziti”;
- Më 11.05.19, ekipi mjekësor me autoambulancë, intervenoi në simulimin e fatkeqësisë në Kolegjin e Shkencave Mjekësore “HAIMER”. Ekipi ka treguar profesionalizëm dhe efikasitet në intervenim;
- Më 12.05.2019, nga ora 11:00, ekipi mjekësor i QMU-së asistoi në garat e Federatës së Çiklizmit të Kosovës;
- QMU në zbatim të vendimit të DSH –Prishtinë, më 22-23.06.19, nga ora 16:00 - 23:00, asistoi me një ekip mjekësor me autoambulancë në aktivitetin e Garave Ndërkombëtare të Lojës 3x3, e cila u mbajt tek amfiteatri “Zahir Pajaziti”;
- Më 26.05.2019, një ekip mjekësor siguroi aktivitetin e garave të vrapimit në parkun “Gërmia”;

Këtë vit kolektivi i QMU-së për herë të parë shënoi Ditën Ndërkombëtare të Mjekësisë Urgjente, më 27.05.2019, në sheshin “Skënderbeu”. Kjo ditë është shënuar duke performuar 5 ekipe mjekësore me autoambulanca, me ç’rast qytetarëve u ndanë fletushka për veprimtarinë e QMU-së, si dhe këshilla se si të reagojnë në një rast urgjent jetëkërcënues;

- Më 28.06.2019, në sallën e hotelit “Semitronix” në Fushë-Kosovë është mbajtur trajnim në kuadër të programit për adaptimin dhe implementimin e 7 (shtatë) udhërrëfyesve për përdorim të brendshëm në

- QMU – Prishtinë dhe Shërbimi Urgjent në Prizren, monitoruar nga stafi i ekspertëve suedezë, IMP/KMC Lishoping – Suedi;
- Në zbatim të aprovimit nga DSH për asistencë mjekësore, një ekip mjekësor i QMU-së, me autoambulancë, më 30.05.2019 dhe 01.06.2019, në stadiumin "Fadil Vokrri", siguruan dy ndeshje futbollistike, sipas orarit të kërkuar nga FFK-ja;
 - Organizuar nga USAID “Komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse” (TEAM), dhe në përputhje me Planin e punës së projektit për vitin 2019, më 28, 30 dhe 31 maj 2019, projekti “TEAM” është mbajtur një punëtori njëditore për anëtarët e Komisioni të vlerësimit. QMU është përfaqësuar nga ekipa prej 6 anëtarëve, ndërsa punëtorja është mbajtur në hotelin “Emerald”;
 - Më 02.06.2019, në kohëzgjatje prej ores 9:00 deri në orën 13:00, QMU me një ekip mjekësor dhe autoambulancë, ka siguruar aktivitetin “Prishtina vrapon”;
 - Më 05.06.2019, duke filluar nga ora 15:00, ekipi i QMU-së ka siguruar ndeshjen futbollistike në mes kombëtareve të Kosovës dhe Shqipërisë për kategorinë U19. Ndeshja është luajtur në stadiumin e qytetit “FadilVokrri”;
 - QMU, më: 06.06.2019, në ora 15.30, ishte pjese e aktivitetit “Atletika për fëmijë – Prishtina”, me një ekip mjeksor dhe një ekip i rezervuar për gatishmëri nëse paraqitet nevoja. Aktiviteti është zhvilluar në stadiumin e qytetit “Fadil Vokrri”;
 - Më 08.06.2019, duke filluar nga ora 9:00, një ekip mjekësor siguroi aktivitetin e garave me biçikleta nga Rrethi i Flamurit deri në parkun “Gërmia” dhe kthim anasjellta në orën 12:00;
 - Më 09.06.2019, duke filluar nga ora 8:00 deri në orën 20:00, QMU me një ekip mjekësor ka siguruar garen e vrapimit “Gërmia Ultra Trail 2019”;
 - Më 10.06.2019, duke filluar nga ora 17:45 deri në orën 20:30, ekipi mjekësor i QMU-së siguroi stërvitjen e kombëtareve të Kosovës dhe Turqisë, në stadiumin “Fadil Vokrri”;
 - Më 11.06.2019, kemi prezentuar në takimin zyrtar, ku ishte i pranishëm edhe përfaqësuesi i FIFA-s. Takimi është mbajtur në orën 10:30, ku të gjithë aktorët u njoftuan me rregullat e organizimit që i parasheh FIFA;
 - Më 11.06.2019, nga ora 18:00 ekipi i QMU-së siguroi ndeshjen zyrtare, KOSOVA /U21 VS- TURQIA / U21, ndeshja është zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”;
 - Më 15.06.2019, duke filluar nga ora 19:00, me një ekip mjekësor është asistuar në sigurimin e koncertit të muzikes rock “Metal United World Wide II”. Koncerti është mbajtur në Amfiteatrin e Gërmisë;
 - Më 15.06.2019, duke filluar nga ora 18:00, dy ekipe mjekësore siguruan ndeshjen miqësore të yjeve të futbollit, të organizuar nga Rashica –Xhaka, e luajtur në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. QMU mori pjesë në

kuadër të ushtrimit gjithpërfshirës sektorial mjekësor sipas planit Emergjent të LKIA-së. Ushtrimi është mbajtur në Aeroportin LIMAK Kosova International “Adem Jashari”, më 18.06.2019. Ekipi mjekësor qëndroi në gatishmeri nga ora 08:00, në pritje të thirrjes për reagim, me këtë rast është testuar koha e arritjes në Aeroport, ndërsa në skenën e ushtrimit ka vepruar, sipas skenarit të organizatorit në triazimin dhe transportin e të lënduarve.

- Ekipi mjekësor i QMU-së, më 22.06.2019, prej ores 16:00 deri në orën 23:00 siguroi Garën ndërkombëtare të lojës 3x3, që është mbajtur në amfiteatrin “Zahir Pajaziti”. I njëjti aktivitet ka vazhduar më 23.06.2019, duke filluar nga ora 16:00-23:00, i cili është siguruar me një ekip mjekësor dhe autoambulancë;
- Më 25.06.2019, nga ora 14:45, në stadiumin “Fadil Vokrri”, QMU asistoi në ndeshjen futbollistike SP Tre Penne (SMR) –FC, ndeshja është luajtur në stadiumin “Fadil Vokrri”;
- Më 26.06.2019, duke filluar nga ora 16:00 deri në orën 21:00, QMU siguroi aktivitetin në gara “Red Bull Reign”. Aktiviteti është mbajtur në Fushën e Basketbollit në Gërmi, rruga “Bajram Gogaj”;
- Më 28.06.2019, duke filluar nga ora 10:30 deri në orën 12:00, ekipi nga QMU-ja, në Bibliotekën kombëtare “Pjetër Bogdani” ka siguruar aktivitetin e personave të moshuar mbi 80 vjeç;
- Më 28.06.2019, QMU me një ekip mjekësor ka siguruar tubimin e Vidovdanit në Gazimestan, me pjesëmarrje të qytetarëve të nacionalitetit serb. Tubimi ka kaluar pa problem;
- Më 28.06.2019, duke filluar nga ora 17:45, ekipi mjekësor nga QMU ka siguruar ndeshjen futbollistike ndërkombëtare KF “Ferronikeli” (KOS)-Lincoln Red Imps (GIB);
- Më 27 dhe 28.06.2019, është mbajtur trajnimi i stafit mjekësor lidhur me implementimin e Pilotprojektit të Mjekimit të Infarktut Akut të Miokardit me PCI në rajonin e Prishtinës;
- Më 04.07.2019, dy ekipe mjekësore nga QMU kanë mbështetur dhe siguruar aktivitetin diplomatik të manifestimit me rastin e 4 korrikut, Ditës së Pavarsisë së SHBA-së; Ekipet mjekësore kanë qëndruar në lokacionin e Ambasadës, nga ora 15:00 deri në orën 22:00;
- Më 15.07.2019, ekipi mjekësor nga QMU ka siguruar trajnimin e KF “Ferronikli” dhe TNS Wels - Britani e Madhe, ndërsa më 16.07.2019, ka siguruar ndeshjen zyrtare të këtyre dy skuadrave, e vlefshme për Ligen e Kampionëve të Evropës;
- Më 25, 26, 27 dhe 28 korrik 2019, ekipet mjekësore siguruan manifestimin “Birrafest” në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë. Ekipi ka qëndruar prej orës 19:00 deri në orën 24:00;
- Më 23.07.2019, një ekip mjekësor nga QMU, ka siguruar ndeshjet e mini turnirit të e yjeve veteranë me futbollist nga të gjitha trevat shqiptare, si

nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Turniri është mbajtur në nderim të legjendes së futbollit Fadil Vokrri, me rastin e një vjetorit të vdekjes së tij. Ekipi mjekësor ka qendruar prej orës 15:00 deri në orën 21:00;

- Më 30.07.2019, Dy ekipe mjekësore të QMU-së siguruan ndeshjen futbollistike e vlefshme për kupën e UEFA-së në mes KF "Ferronikli" - Drenas dhe "Slovak Bratislavë - Slovaki. Ndeshja është luajtur në stadiumin "Fadil Vokrri", ndërsa ekipet mjekësore kanë qëndruar në stadium prej orës 15:30 deri në orën 20:30;
- Gjatë muajit gusht 2019, temperaturat ishin të larta, mbi 35°C, dhe në këtë situatë QMU-ja me miratimin e DSH-së, ka vendosur një autoambulancë me ekip mjekësor te sheshi "Skënderbeu" për ndihmë qytetarëve. Ekipet kanë qëndruar në shesh gjatë ditës, prej orës 10:00 deri në orën 16:00, me ç' rast qytetarët janë këshilluar mbi mbrojtjen nga temperaturat e larta;
- Më 24.08.2019, QMU mbështeti aktivitetin Marshi me biçikleta". Aktiviteti është mbajtur në rrugët e Prishtinës, nga ora 10:00 deri në orën 13:30.
- Më 29.08.2019, prej orës 17:30 deri në orën 21:30, një ekip mjekësor ka asistuar në stërvitjet e kombëtareve të Kosovës dhe të Turqisë, të gjinisë femrore;
- Më 30.08.2019, u asistua edhe në ndeshjen kombëtare femra "Kosovë - Turqi", e cila u zhvillua në stadiumin e qytetit "Fadil Vokrri";
- Më 31.08.2019, nga ora 10:00 deri në orën 13:00. një ekip mjekësor asistoi në aktivitetin "Vrapojmë për dije". Aktiviteti është mbajtur në sheshin "Zahir Pajaziti" nga komunitetit RAE.
- Më 06.09.2019, nga ora 13:30 deri në orën 18:00, ekipi mjekësor i QMU-së siguroi stërvitjet e dy kombëtareve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Çekisë në stadiumin e qytetit "Fadil Vokrri".
- Më 07.09.2019, u siguroa ndeshja zyrtare e kualifikimeve për Kampionatin Evropian mes dy ekipeve kombëtare, Kosovë -Çeki, që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri";
- Ekipet mjekësore të QMU-së asistuan në Amfiteatrin e Gërmisë për sigurimin e Festivalit "ROCK UNITED", gjatë dy ditëve, më 06.09.2019 duke filluar prej orës 21:00 - seri në orën 1:00, dhe më 07.09.2019 prej orës 21:00 deri në orën 1:00;
- Më, 11.09.2019, ekipi mjekësor siguroi ndeshjen ndërkombëtare mes klubeve të femrave "Mitrovica" - "Wolfsburg" (Gjermani), ku morëm pjesë së bashku me zjarrfikësit, FSK-në, Policinë e Kosovës dhe përfaqësuesit e Ambasades së SHBA-së në sheshin "Bill Clinton" në përkujtimin e viktimave të 11 shtatorit të vitit 2001 në Nju-Jork, organizuar nga shoqata "Miq të Amerikës";
- Më, 21.09.2019, ekipi i QMU-së siguroi garat e biçiklistëve të rinj në qytetin e Prishtinës;

- QMU asistoi gjithashtu edhe me një ekip dhe autoambulancë, më 21 dhe 22 shtator në Grashticë, gjatë garës automobilistike. Gara është zhvilluar në organizim të klubit automobilistik “Prishtina”;
- Më 30 shtator, në kuadër të edukimit të nxënësve kemi mbajtur një ligjeratë në shkollën model “Qamil Batalli” të komunës së Prishtinës:
 - Tema: Njohja e nxënësve me veprimtarinë e QMU-së, ndihma e parë dhe intervenimet urgjente;
- Më 09.10.2019, në intervalet kohore prej orës 9:30 deri në orën 11:30 dhe po në të njejten ditë nga ora 17:30 deri në orën 19:30 ekipi mjekësor i QMU-së siguroi gjatë stërvitjes së Kombëtares së Gjibraltarit dhe Kombëtarës së Kosovës, mbajtur në stadiumin e qytetit të Prishtinës “Fadil Vokrri”;
- Më 10.10.2019, nga ora 16:00 deri në orën 21.00, dy ekipe nga QMU asistuan në ndeshjen miqësore ndërmjet Reprerentacionit të Kosovës dhe atij të Gjibraltarit, e cila është luajtur në stadiumin „Fadil Vokrri”;
- Më 13.10.2019, prej orës 16:00 deri në orën 20:00, një ekip mjekësor siguroi stërvitjet nga ora 16.00 deri në orën 20.00 të dy kombëtareve, të Malit të Zi dhe të Kosovës;
- Më 14.10.2019, dy ekipe mjekësore nga QMU siguruan ndeshjen zyrtare të vlefshme për kualifikim në Kampionatin Evropian, ndërmjet reprerentacionit të Kosovës dhe atij të Malit të Zi, në stadiumin e qytetit të Prishtinës “Fadil Vokrri”;
- Më kërkesë të organizatorit nga FFK-ja, ekipi mjekësor i QMU-së ka ofruar asistencë me një ekip dhe një utoambulancë për stervitjen zyrtare, më 16.11.2019, nga ora 17:30 deri ne orën 19:30, stervitjen e reprerentacionit të Kosovës në stadiumin “Fadil Vokrri”;
- Në ditën e ndeshjes në mes të reprerentacionit futbollistik të Kosovës dhe të Anglisë, më 17.11.2019, asistuan 3 ekipe me autoambulanca, nga ora 15:00 deri në orën 21:00, në stadiumin e qytetit “Fadil Vokrri”;
- Më 23.11.2019, është mbajtur ceremonia e ditëlindjes së Marinës së SHBA-së në hotelin “Emerald”. Gjatë kësaj jkohe në këtë ceremoni QMU asistoi me një ekip mjekësor, me kërkesën e Ambasadës së SHBA-së dhe miratim të DSH;
- Më 29.11.2019, duke filluar nga ora 8:10 deri në orën 9:30, është mbajtur kolegjiimi mjekësor, ku janë diskutuar problemet dhe sfidat gjatë punës në QMU dhe janë propozuar zgjidhjet për problemet me të cilat ballafaqohet stafi mjekësor;
- Më 15.12.2019, nga ora 12:00 deri në orën 14:00, ekipi i QMU-së asistoi në manifestimin sportiv “Vrapo Babadimër”, i mbajtur në sheshin “Zahir Pajaziti”.
- Më 26.12.2019, duke filluar nga ora 8:10 deri në orën 9:30, u mbajt Kolegjiimi mjekësor, ku u diskutuan problemet, sfidat dhe ballafaqimet në punë gjatë vitit 2019 në QMU. Ndërkaq u propozuan zgjidhjet në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve;
- Më 31.12.2019, u shpallën punëtorët e dalluar, të cilëve u janë ndarë mirënjohje, nga menaxhmenti dhe drejtori i DSH-së.

EVM – Temat e zhvilluara gjatë vitit kalendarik 2019:

- Urgjencat kirurgjike te fëmijët;
- Sinusiti acut dhe epistaksa;
- Legjislacioni për urgjenca në Kosovë;
- Edema pulmonare;
- Epilepsia dhe statusi epileptik;
- Gjendjet septike dhe meningjiti acut;
- Gjakderdhjet që kërkojnë ndërhyrje urgjente;
- Çrregullimet e ritmit kardiak;
- Urgjencat psikiatrike dhe tretmani paraspitalor;
- Intoksikimi me droga, alkool dhe trajtmi paraspitalor;
- Menaxhimi i stresit te punëtorët e urgjencës;
- Syncopa dhe menaxhimi paraspitalor.

➤ Shërbimet në periudhën raportuese, janar – dhjetor 2019 – QMU:

Vizita mjekësore në terren – 16148;

Vizita mjekësore në QMU – 6961;

Shërbiimi i kirurgjisë së vogël – 371;

Shërbimi i reanimimit – 183;

Shërbimi gjysmëintenziv – 3015;

Shërbimi i infermierisë – 1974;

Aksidente – 1027;

Fatkeqësi – 738;

Shërbimi laboratorik – 1752;

EKG – 967;

Transportet – 3995;

Konstatim vdekje – 622;

Gjithsej 37753 shërbime shëndetësore.